



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:232270

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05433377

Ca.nr.2614/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu – kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në çështjen juridike të paditëses - propozueses Z.R nga P, Lagjia D. Rruga Nr...., kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit të panjohur, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditëses/propozueses së masës të sigurimit, e ushtruar kundër aktvendimit C.nr.6028/2023 datë 01.12.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 08.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses – propozueses së sigurimit Z.R nga P, Lagjia D. Rruga Nr...., ndërsa aktvendimi C.nr.6028/2023 datë 01.12.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.6028/2023 datë 01.12.2023, ka vendosur si në vijim: *“I. KONSIDEROHET e tërhequr padia dhe propozimi për caktimin e masës së përkohshme me numër C.nr.6028/23, e ushtruar me datën 31.10.2023, e paditëses - propozueses Z.R, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit të panjohur, lidhur me lirim të paluajtshmërisë - bodrumit. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”*.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësja/propozuesja e masës së sigurimit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, dhe e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën ashtu që ta anulon aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe te detyrohet, gjykata e shkallës së parë që të procedojë çështjen juridike Kontestimore ashtu që çështja të kthehet në procedim të serishëm.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja/propozuesja e masës së sigurimit ka paraqitur padi me datë 31.10.2023, ndaj të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, baza e kontestit lirim palujtshmërie më konkretisht me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.6028/2023 të datës 01.11.2023, e ka kthyer padinë dhe propozimin për masë të sigurisë tek paditësja në plotësim, duke e kërkuar nga paditësja/propozuesja e masës së sigurimit, që ta plotësoi padinë në aspektin subjektiv, duke e përcaktuar palën e paditur/kundërshtarit të sigurimit me të dhënat e tij personale përfshirë edhe adresën e të njëjtit, sepse në padi e as në propozim për masë të sigurisë nuk janë paraqitur të dhënat personale të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, andaj edhe nuk mund të dihet se kush është i padituri dhe ndaj kujt është ushtruar padia e as propozimi për masë të sigurisë. Me aktvendimin e lartcekur procedural gjykata e shkallës së parë palës paditëse/propozueses i ka caktuar afatin 3 ditor për ti plotësuar të dhënat e lartcekura në të kundërtën do të hedhet poshtë propozimi.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, me datën 01.11.2023, ka nxjerr aktvendimin me anë të së cilës ka kërkuar nga paditësja që ta plotësoj padinë dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të datës 31.10.2023, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi në aspektin subjektiv, duke e përcaktuar palën e padituri – kundërshtarit të sigurimit, me të dhënat e tij personale dhe adresë të saktë të vendbanimit. Aktvendimin në fjalë paditësja – propozuesja e ka pranuar me datën 02.11.2023, kurse me datë 06.11.2023, ka paguar taksat gjyqësore për padi dhe propozim për caktimin e masës së përkohshme. Por se e njëjta nuk e ka plotësuar padinë dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të datës 31.10.2023, në aspektin subjektiv, duke përcaktuar palën e paditur dhe të dhënat e tij personale, edhe pse një obligim i tillë kishte rrjedhur nga aktvendimi i kësaj gjykate i datës 01.11.2023. Me dispozitën e nenit 102 par.3 të LPK-së, përcaktohet: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*. Meqenëse paditësja nuk ka vepruar sipas aktvendimit në fjalë, duke mos e plotësuar padinë në aspektin subjektiv brenda afatit të dhënë, gjykata padinë dhe

propozimin për caktimin e masës së përkohshme të paditëses – propozueses e konsideroj të tërhequr.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe po ashtu drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të paditëses/propozueses të masës së sigurisë gjen se nuk qëndrojnë pretendimet se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, për faktin se dispozitivit i aktvendimit nuk është në kundërshtim me arsyetimin e aktvendimit dhe janë treguar qartë arsyet në aktvendimin ankimuar pse është ardh deri në përfundim për të vendosur ashtu siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktvendimin të ankimuar.

Gjykata ankimore vlerësoi pretendimet ankimore të paditëses/propozueses së sigurimit pas që e njëjta pretendon se konform aktvendimit C.nr.6028/2023 të datës 01.11.2023, procedural të gjykatës së shkallës së parë, e ka plotësuar padinë dhe propozimin për masë të sigurisë si dhe e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore ashtu siç është kërkuar me aktvendimin e lartcekur. Mirëpo këto pretendime të paditëses/propozueses së sigurimit vlerësohen nga kjo gjykata si të paqëndrueshme sepse paditësja/propozuesja e sigurimit sipas shkresave të lëndës, nuk e ka plotësuar padinë propozimin e masës së sigurimit me të dhënat personale të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, siç janë emri, mbiemri dhe adresa e të paditurit, pa të cilat të dhëna gjykata nuk ka mundësi që ta procedon këtë çështje më tej. Në shkresat e lëndës së bashku më ankesën e paditëses/propozuese së sigurimit, i është bashkangjitur ankesë një parashtrësë e datës 14.12.2023, ku figuron emri dhe mbiemri i të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, mirëpo prej shkresave të lëndës më asnjë provë shkresore nuk është vërtetuar se parashtrësja e lartcekur e paditëses/kundërshtares së sigurimit, që është dorëzuar ndonjëherë në gjykatën e shkallës së parë. Andaj gjykata shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore të paditëses/ propozues së sigurimit se e njëjta e ka bërë pagesën e taksës gjyqësor siç është detyruar nga gjykata me aktvendimin e lartcekur procedurale, e cila çështje nuk është kontestuese që është bërë pagesa e taksës gjyqësore

si për padi ashtu edhe për masë të sigurisë sipas urdhërpagesave të datës 06.11.2023, ashtu siç edhe e ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar. Mirëpo ashtu siç u arsyetua në lart edhe nga kjo gjykatë, padia dhe propozimi i paditëses/propozueses së sigurimit, nuk ju ka konsideruar e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore, por për shkak të mos plotësimit të padisë dhe propozimit me të dhënat personale të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, prandaj edhe këto pretendime të paditëses/propozueses ishin pa ndikim për një vendosjes ndryshe nga ajo që është vendos në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2614/2024 me datë 08.03.2024

Kryetar i kolegjit
Adnan Konushevcı d.v.